



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 06/12 Prot.

Tiranë, më 27.04.2021

V E N D I M

Nr. 24, datë, 16. 04. 2021

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe, datë 08.02.2021, "Për procedimin disiplinor të oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Dritan Veliu", protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numër protokoll 06, datë 10.02.2021, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36. pika 1 e ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ka nxjerrë Urdhërin nr.16, datë 03.03.2021 "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Dritan Veliu, për kryerjen e shkeljeve disiplinore në formën e:

- "zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të policisë gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj",
 - "mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht.",
 - "Paraqitja e të dhënave dhe akteve që lidhen me kryerjen e një vepre penale, në tejkallim të afateve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale" dhe
 - "kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Procedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes",
- të parashikuara si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", **neni 33, pika 3, gërmat "a", "ç" dhe pika 4, gërmat "b" dhe "ç"** të këtij ligj.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit Andi Pogaçe dhe dokumentat që e shoqërojnë atë, rezulton se si bazë për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkellje të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore të Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Dritan Veliu, gjatë hetimit të procedimit penal nr.1019, regjistruar në datën 19.09.2020, në ngarkim të shtetasit Klaus Mahmuti, për veprën penale “Largimi nga vendi i aksidentit” dhe “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga nenet 273 dhe 290/3 të Kodit Penal.

Nga aktet që u administruan gjatë seancës dëgjimore për procedimin disiplinor, u provua se:

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në datën 19.09.2020 ka regjistruar procedimin penal Nr. 1019, për figurën e veprës penale “*Largim nga vendi i aksidentit dhe shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor*”, të parashikuar nga neni 273 dhe neni 290/3 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Klaus Mahmuti. Për hetimin e këtij procedimi penal është ngarkuar oficeri i Policisë Gjyqësore i Shërbimit të Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Dritan Veliu, i cili ka referuar edhe materialin kallëzues në prokurori.

- Na aktet e procedimit penal rezulton se në datën 17.09.2020, shtetasi Klaus Mahmuti i cili qarkullonte me automjetin e tij, tip Fiat-Punto në rrugën automobilistike Fier-Seman, ka goditur shtetasin Qani Metaj, i cili udhëtonte me biciklet në drejtimin Seman-Fier. Si pasojë e këtij aksidenti ka gjetur vdekjen shtetasi Qani Metaj. Për këtë ngjarje është arrestuar në flagrancë shtetasi Klaus Mahmuti, ndaj të cilit Gjykata ka caktuar masën e sigurisë “Arrest me burg”. Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu, pasi janë kryer veprimet e para hetimore, janë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

2.1 Në vijim të hetimeve, në cilësinë e prokurorit të çështjes, prokurori Andi Pogaçe, në datën 17.10.2020 ka nxjerrë “Urdhërin për delegimin e veprimeve hetimore” me të cilin, në funksion të hetimit të plotë të procedimit penal, i delegon oficerit të policisë gjyqësore, Dritan Veliu kryerjen e disa veprimeve hetimore. Në urdhër i vihet afat oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu që veprimet hetimore të kryhen brenda datës 15.11.2020. Meqënëse emri i shtetasit Klaus Mahmuti është regjistruar në regjistrin e autorëve të veprave penale, në datën 18.09.2020 dhe afati i hetimeve të procedimeve është tre muaj nga momenti i regjistrimit të emrit të autorit të veprës penale, si dhe duke patur parasysh detyrimin e Prokurorisë të informojë çdo dy muaj Gjykatën për të arrestuarin nga momenti i caktimit të masës së sigurimit “Arrest me burg”, prokurori ka caktuar datën 15.11.2020 si afat për kryerjen e veprimeve hetimore nga oficeri i Policisë Gjyqësore. Njëkohësisht në urdhër, i kërkohet oficerit të Policisë Gjyqësore të informojë prokurorin çdo javë, nëpërmjet postës elektronike, për veprimet hetimore të kryera ose që nuk janë kryer.

Por, nga kërkesa e Prokurorit Andi Pogaçe dhe nga aktet e dosjes rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Dritan Veliu gjatë hetimit të këtij procedimi penal ka zvaritur hetimet dhe shumë veprime hetimore të kërkuar nga prokurori, nuk janë kryer ose janë kryer tej çdo afati ligjor për hetimin, duke sjellë pavlefshmërinë dhe papërdoshmërinë e tyre. Gjithashtu oficeri i policisë gjyqësore Dritan Veliu nuk ka informuar dhe nuk ka dërguar asnjëherë informacionin javor të kërkuar nga prokurori.

Megjithëse afati i kryerjes së veprimeve hetimore ka qenë data 15 Nëntor 2020, oficeri i policisë gjyqësore Dritan Veliu, nuk i është përgjigjur kërkesave të prokurorit, duke mos

dorëzuar aktetet e proçedimit te prokurori. Deri në momentin që prokurori Andi Pogaçe ka nisur kërkesën për proçedimin disiplinor, aktet e proçedimit penal mbaheshin, pa u dorëzuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Dritan Veliu, megjithë kërkesat e vazhdueshme të prokurorit.

Konkretrisht, nga materialet që i bashkangjten kërkesës për proçedimin disiplinor, rezulton se meqëse që nga momenti i delegimit të fashikullit të hetimeve e deri në datën 13 Janar 2021, prokurori nuk ka patur asnjë informacion për fatin e proçedimit penal dhe për veprimet e kryera si dhe kishin kaluar afatet e hetimit, i ka dërguar oficerit të Policisë Gjyqësore Dritan Veliu në numrin e tij celular 0694112923 mesazhin përmbajtjen: **“Mirëdita Dritan, brenda javës duhet të sjellësh të përfunduar dosjen për 290/3 ndaj Klaus Mahmutaj.”** Nga ana e tij, oficeri Dritan Veliu është përgjigjur duke dërguar në numrin celular të prokurorit, 0694135217 mesazhin me përmbajtje: **“Kuptova”**.

Duke qenë se, pavarësisht komunikimit të mëparshëm, fashikulli i proçedimit penal nuk i është dërguar nga oficeri i Policisë Gjyqësore në javët pasardhëse, në datën **22 Janar 2021** (rreth 9 ditë pas mesazhit të parë), Prokurori i ka dërguar oficerit Dritan Veliu mesazhin tjetër me përmbajtje: **“Mirmëngjes, përse nuk e keni sjellë dosjen sipas urdhrin të delegimit dhe urdhrin të datës 13.01.2021?”**. Nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Dritan Veliu nuk është kthyer përgjigje.

2.2 Lidhur me veprimet hetimore dhe afatet e hetimit të proçedimit penal, të parashikuara në Kodin e Proçedurës Penale, sikurse rezulton nga aktet e dosjes penale, shumë veprime hetimore janë kryer tej afatit të caktuar në urdhërin e delegimit të prokurorit dhe tej afatit 3 muajor që parashikon neni 323 i K.K.Pr.Penale. Neni 323 i K.Pr.Penale parshikon se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale”. Kryerja e veprimeve hetimore tej këtij afati dhe në mungesë të zgjatjes se afatit të hetimit me vendim të prokurorit, bëjnë që provat e grumbulluara nga këto veprime të jenë të papërdorshme.

2.3 Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre dhe shjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, provohet se gjatë hetimit të proçedimit penal nr. Nr. 1019, të vitit 2010 , nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu , janë shkelur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale, të cilat kanë çuar në papërdoshmëri të provave, me pasoja për kryerjen e hetimit brenda afateve ligjore dhe zgjidhjen e përfundimtare të proçedimit penal brenda këtyre afateve. Komisioni konstaton se nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu , gjatë hetimit të proçedimit penal nr.1019 të vitit 2010 janë kryer shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale sikurse janë:

- Shkelja e kërkesave të nenit 323 të Kodit të Proçedurës Penale, i cili parashikon se hetimet duhet të përfundojnë brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale. Sikurse rezulton nga aktet e proçedimit penal, me urdhër datë 18.109.2020 të prokurorit të çështjes Andi Pogaçe, emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale, Klaus Mahmuti, është regjistruar që në datën 18.09.2020. Rezulton, se megjithese afati i hetimit përfundonte në muajin dhjetor 2020, oficeri i policisë gjyqësore nuk i ka kryer të gjitha veprimet hetimore brenda këtij afati dhe nuk ka kërkuar nga prokurori zgjatjen e afatit të hetimit. Madje, edhe kur prokurori ka kërkuar informacion nga oficeri i policisë gjyqësore per ecurin e hetimeve dhe aktet e proçedimit penal,

oficeri policisë gjyqësore Dritan Velu nuk ka reagu, por ka vazhduar të mbajë dosjen tej këtyre afateve. Mbajtja e procedimit penal, tej afateve ligjore ka çuar në kalimin e çdo afati ligjor për hetimin, me pasojë pavlefshmëinë e veprimeve hetimore dhe papërdoshmërinë e provave të marra në tejkalim të afatit të përcaktuar në ligj.

- Me mbajtjen e procedimit penal tej çdo afati dhe mosinformimin e prokurorit për ecurinë e hetimeve, në mungesë të fashikullit të procedimit penal, i ka hequr mundësinë prokurorit të marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, duke shkelur kërkesat e nenit 324/4 të Kodit të Procedurës Penale..

- Nuk janë kryer veprimet e deleguara nga prokurori, brenda afatit të caktuar nga prokurori dhe brenda afatit tre mujor të parashikuar nga neni 323 i K.Pr.Penale dhe nuk ka informuar prokurorin në vijimësi për ecurinë e hetimeve dhe nuk ka dorëzuar dosjen te prokurori megjithë kërkesat e vazhdueshme të tij, duke cënuar dhe shkelur kërkesat e Kodit të Procedurës Penale për afatet e hetimit dhe ato që rregullojnë marrdhëniet midis oficerit të policisë gjyqësore dhe prokurorit.

3. Në çmim të Komisionit, shkeljet e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerjen brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdhërin e delegimit të prokurorit, të veprimeve hetimore si dhe mosinformimi në vijimësi i prokurorit për ecurinë e hetimeve, të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Gazmend Idrizi, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuar nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

- Komisioni vlerëson se shkelja e kërkesave të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, mbajtja në dorë e procedimit penal, pa kryer veprime hetimore tej afatit tre mujor, dhe pasojat që ka sjellë kryerja e veprimeve hetimore tej këtij afati, përbëjnë shkelje disiplinore në formën e **“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat pasjellin zvarritje të proçeseve hetimore”**, parashikuar nga **neni 33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

- Gjithashtu, Komisioni vlerëson se me veprimet dhe mosveprimet e oficerit të policisë gjyqësore Dritan Velu, duke mos ju përgjigjur prokurorit dhe kërkesave të tij për informacion për ecurinë e hetimeve dhe dërgimin e fashikullit të hetimit te prokurori i çështjes, përbëjnë shkelje disiplinore në formën **“Shkelja e rregullave të etikës”**, parashikuar nga **neni 33, pika 2, gërma “c” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Oficerët e policisë gjyqësore, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe kërkesave për integritetin e tyre gjatë ushtrimit të detyrës, kanë detyrimin të respektojnë rregullat e komunikimit si me qytetarët ashtu dhe eprorët e tyre. Gjatë ushtrimit të detyrës ata kanë detyrimin që jo vetëm të zbatojnë me rigorozitet aktet ligjore por dhe rregullat dhe standartet etike në ndërtimin e mardhënieve me prokurorin. Oficeri i policisë gjyqësore, referuar nenit 7 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ushtron funksionet e tij për hetimin e çështjes konkrete nën varësinë e prokurorit dhe drejtohet e kontrollohet prej tij. Ai zbaton urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve.

3.1 Lidhur me shkeljet disiplinore të parashtruara në kërkesën e prokurorit Andi Pogaçe dhe në Urdhërin për fillimin e procedimit disiplinor, “zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e

veprimeve të oficerëve të policisë gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj”, “ mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht”, “paraqitja e të dhënave dhe akteve që lidhen me kryerjen e një vepre penale, në tejkallim të afateve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Proçedurës Penale,” dhe “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja për hetimin e çështjes”, të parashikuara si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 3, gërmat “a”, “ç” dhe pika 4, gërmat “b” dhe “ç” të këtij ligji, Komisioni arrin në konkluzionin se, këto shkelje nuk janë kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Dritan Veliu.

3.2 Për konsumimin e shkeljes parashikuar në nenin 33, pika 3, germa “a” e ligjit 25/2019, “zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të oficerëve të policisë gjyqësore gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj”, kërkohet ekzistenca njëkohësisht e dy kushteve, zvarritja e hetimeve të jetë e pajustificuar dhe që ajo të jetë e përsëritur. Në qoftëse mungon njëri nga këto kushte, shkelja nuk mund të klasifikohet sipas kësaj pike dhe gërme të nenit 33 të ligjit 25/2019.

Në rastin në shqyrtim, Komisioni konstaton se nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu janë lejuar zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit të proçedimit penal nr.1019, të vitit 2019, por këto zvarritje nuk janë të përsëritura, në kuptim të dispozitës së sipërcituar. Nga kërkesa e prokurorit për procedim disiplinor dhe aktet e administruara , nuk rezulton që oficeri i policisë gjyqësore Dritan Veliu të ketë kryer apo të jetë ndeshkuar disiplinarisht për zvarritje të hetimit në proçedime penale të tjera.

Duke patur parasysh sa më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se kjo shkelje duhet klasifikuar si shkelje disiplinore në formën e “*veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore* “. parashikuar nga neni 33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019”

3.3 Edhe për shkeljen disiplinore, në formën e “paraqitja e të dhënave dhe akteve që lidhen me kryerjen e një vepre penale , në tejkallim të afateve dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Proçedurës Penale”, parashikuar nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, neni 33, pika 4, gërmat “c”, Komisioni, nisur nga leximi dhe interpretimi i kësaj dispozite të ligjit, arrin në përfundimin se nuk është kryer. Në këtë parashikim, ligjvënësi ka parasysh shkeljen nga oficeri i policisë gjyqësore të afateve të parashikuara në nenin 293 të K.Pr.Penale për referimin e veprës penale të prokurorit. Sipas këtij neni, me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonese por jo më vonë se 72 orë, i referon prokurorit me shkrim, elementët thelbësorë të faktit dhe të dhenat e mbledhura si dhe i vë në dispozicion prokurorit për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e mbledhura. Shkelja e këtyre afateve, sjellë përgjegjësi disiplinore sipas kësaj pike dhe shkronje të nenit 33 të ligjit 25/2019.

3.4 Lidhur me dy shkeljet e tjera, të parashtruar në kërkesën për proçedimin disiplinor, të kryera në formën “ mosinformimi i prokurorit për ecurinë e hetimeve nga oficeri drejtues që ka për detyrë të informojë kryesisht”, dhe “kryerja e veprimeve dhe mosveprimeve të tjera në kundërshtim me dispozitat urdhëruese apo ndaluese të Kodit të Proçedurës Penale, me pasoja

për hetimin e çështjes”, të parashikuara si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019, neni 33, pika 3, gërma “ç” dhe pika 4, gërma “ç”, konstatohet se nuk janë kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Dritan Veliu, veprimet që pretendohen si shkelje disiplinore, mosdërgimi i informacionit çdo javë nga oficeri te prokurori në rrugë elektronike, dhe se me vonesat në dërgimin e dosjes u ka pamundësuar viktimave nga vepra penale marrjen e informacionit dhe akteve të procedimit, penal për vetë natyrën e tyre, rrethanat në të cilat kanë ndodhur dhe fakti që nuk kanë sjellë pasoja të pariparueshme për hetimin e çështjes, nuk mund të ngrihet në nivelin e shkeljes disiplinore, të parashikuar nga gërma “ç”, pika 3 dhe gërma “ç” e pikës 4 të nenit 33 të ligjit 25/2019, dhe të klasifikohen si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, në kuptim të ligjit.

3.5 Në përfundim, në analizë dhe vlerësim të akteve të administruar gjatë shqyrtimit të procesit disiplinor, përfshirë dhe sqarimet dhe shpjegimet e subjektit të procedimit disiplinor, Komisioni i Policisë Gjyqësore, arrin në përfundimin se nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu, me veprimet dhe mosveprimet e tij, gjatë hetimit të procedimit penal nr.1019/2020, janë kryer shkeljet disiplinore në formën:

-“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proceseve hetimore”, parashikuar nga neni 33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. dhe

- “shkelja e rregullave të etikës, paraashikuar nga neni 33, pika 2, gërma “c” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Dritan Veliu shpjegon se, nuk ka kryer shkelje, vonesat kanë ardhur për shkak se është larguar për disa ditë, për arsye shëndetësore të djalit në Itali dhe se nuk i është përgjigjur në kohë ekspertit mjekoligjor.

Sipas shpjegimeve të tij, në veprimtarinë e përditshme, ka kryer dhe detyra të tjera, pjesë e funksioneve të policisë, së qarkullimit rrugor.

Këto shpjegime dhe pretendime të oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu, nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesat në hetimin e procedimit penal. Ngarkesa në punë që oficeri i policisë gjyqësore ka përballuar gjatë përfshirjes së tij në aktivitete të tjera të punës policore, nuk mund të justifikojnë zvarritjet dhe mosplotësimin e detyrimeve ligjore gjatë hetimit të procedimeve penale. Referuar ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenet 2, pika 6 dhe neni 4, gërma “b”, oficerët e policisë gjyqësore të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit, të ngarkuar posaçërisht me kryerjen e hetimeve, kanë detyrimin ligjor për marrjen e masave për respektimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit që rregullojnë dhe dispiplinojnë oficerët e policisë gjyqësore për hetimin e veprave penale.

4. Duke i konsideruar të provuara shkeljet disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Gazmend Dritan Veliu, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33 i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “a”, pika 2, e nenit 33, parashikon si **shkelje të lehtë**, “veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje te proçeseve hetimore”. Ndërsa, në gërmën “c” pika 2 e nenit 33 të ligjit, parashikon si **shkelje të lehtë** “shkelja e rregullave të etikës”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Dritan Velu, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljeve disiplinore të kryera prej tij, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit lidhur me ngarkesën në punë dhe personalitetin e tij. Komisioni merr parasysh faktin që, sikurse rezulton nga shkresa nr.2172/1 prot., datë 06.04.2021 e Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, oficeri i Policisë Gjyqësore, Dritan Velu Idrizi, gjatë vitit 2020 ka përballuar një volum të konsiderueshëm pune si dhe faktin që ndaj tij ekziston masa disiplinore, “vërejtje”, dhënë në vitin 2020 nga strukturat eprorë të tij.

Gjithashtu komisioni i referohet parashikimeve të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, **a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në një vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.**

Në pikën 2 të nenit 34 parashikohet që për shkeljet e lehta jepen masat disiplinore “vërejtje me shkrim” ose “vërejtje me paralajmërim”.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se në rastin objekt shqyrtimi, janë konsumuar dy shkelje disiplinore nga oficeri i Policisë Gjyqësore Dritan Velu, të cilat sipas ligjit 25/2019 klasifikon shkelje të lehta.

Në raste të tilla, kur ka konkurim të shkeljeve disiplinore dhe shkeljeve të konstatuara u përkojnë të njëjtat masa disiplinore, bazuar në nenin 32 të ligjit 25/2019 dhe nenin 1, pikat 6 të Rregullores nr.1, datë 21.04.2020 “Për proçedimin disiplinor”, të Komisionit të Policisë Gjyqësore, Komisioni duhet të japë një masë të vetme disiplinore.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të policisë gjyqësore Dritan Velu të japë masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “b” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4, nenit 33, pika 2, gërmat “a”, dhe “c”, neni 34, pika 1, gërma “b”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me pesë vota pro.

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, i jepet masa disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim”**.
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Dritan Veliu , i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Andi Pogaçe.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Dritan Veliu.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI



ANËTAR

BLEDAR CELIKU

ANËTAR

HARI GOGO

ANËTAR

ARTUR SEJATI

ANËTAR

ALBERT MUÇO